



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH .nr.647/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Rahovica Commerce” SH.P.K – Ferizaj , kundër njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku është rekomanduar për kontratë OE: “Alfa I ” SH.P.K- Lipjan , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Implementimi i planit të mobilitetit-rekonstruim i rrugës Muharrem Fejza” me nr. të prok: 616-19-6284-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Prishtinë” (KK.P), më datën: 14.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Rahovica Commerce” SH.P.K – Ferizaj , kundër njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Implementimi i planit të mobilitetit-rekonstruim i rrugës Muharrem Fejza” me nr. të prok: 616-19-6284-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Prishtinë” (KK.P),

II. ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për aktivitetin e prokurimit me titull: “Implementimi i planit të mobilitetit-rekonstruim i rrugës Muharrem Fejza” me nr. të prok: 616-19-6284-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Prishtinë” (KK.P),
dhe lënda të kthehet në **rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “Rahovica Commerce” SH.P.K – Ferizaj , i aprovohet si pjesërisht e bazuar , i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: “Rahovica Commerce” SH.P.K – Ferizaj , si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 08.09.2020 me nr. 647/20 , kundër njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku është rekomanduar për kontratë OE: “Alfa I ” SH.P.K- Lipjan , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Implementimi i planit të mobilitetit-rekonstruim i rrugës Muharrem Fejza” me nr. të prok: 616-19-6284-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Prishtinë” (KK.P), duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1 , 6 , 7 , 59 , 69 të LPP-së , si dhe nenin 39 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 14.09.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 28.09.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: “Rahovica Commerce” SH.P.K – Ferizaj

Pretendimi nr. 1,

Lidhur me pretendimin e OE “Rahovica Commerce” SH.P.K - Ferizaj, – ankues - OE i rekomanduar për kontratë ka çmime jo normalisht të ulëta sipas nenit 61 të LPP-së pasi që ka çmime tepër të ulëta të pozicioni MBISTRUKTURA në pozicionin 17 (Punimi i bitoagregatit 0 -22 mm, me trashësi t=80.0 mm i përzierje me përforcues asfalti me përbërje të fibrave të Aremidit dhe Polyolefineve) me çmime 6.20 €.

OE ka hyr me logjiken se nuk e bën fare përzierjen me përforcues te fibrave. Pasi qe me çmimin ofertues edhe pa fibra është i lire e lere te beje përzierjen me fibra dhe te oferton me çmim 6.20 €/m2.

Përgjigje në pretendimin nr. 1

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, Njoftimin nr. 33/20 te datës 12.02.2020 dhe Vendimin nr. 261/20 te datës 12.06.2020 te Panelit Shqyrtues konstaton se sqaron se bazuar ne rregulloren nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit , neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”, sipas nenit 105.2.16 te LPP-së. Ky pretendim është shqyrtuar më parë me Njoftimin nr. 33/20 të datës 12.02.2020 ku paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës, raportin e ekspertit shqyrtues, parashtresës se AK –Komuna e Prishtinës se datës 04.02.2020 pas pranimi te raportit te ekspertit shqyrtues ku ka njoftuar OSHP-ne se PAJTOHET me mendimi e dhënë të ekspertit të OSHP-se të datës 03.02.2020 si dhe parashtresës se OE “Rahovica Commerce” SH.P.K së datës 04.02.2020 pas pranimi të raportit të ekspertit shqyrtues ku ka njoftuar OSHP-në së PAJTOHET me mendimi e dhënë të ekspertit të OSHP-se të datës 03.02.2020.

Duke u bazuar në këto fakte eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi nr. 2

Pretendimin e OE “Rahovica Commerce” SH.P.K . – Lidhur me pajisjen "Spërkatëse për Bitumen dhe emulsion, po e sqarojmë me detajisht : Pra, lidhur me këtë pajisje dy here radhazi ka dështuar ta dëshmoj OE "ALFA I. Duke mos e argumentuar me sqarim (sipas nenit 59.2 dhe 72 te LPP-se) se e disponon këtë pajisje edhe OSHP dy here radhazi e ka dëshmuar se ky OE nuk e disponon këtë pajisje dhe automatikisht nuk e plotëson kriterin e FDT-se dhe NJK sipas nenit 59.4 te LPP-se, pasi qe nuk i plotëson te gjitha kriteret e kërkuara ne FDT dhe NJK.

Pretendimet tona qe i kemi paraqitur ne kërkesën për rishqyrtim i gjeni te bashkangjitur si me poshtë:

DUD-i me nr. IE 0017986 i datës 14.05.2020 qe e dëshmon se OE e ka vulosur pas datës se hapjes se tenderit (17.09.2019), pra i bie afro 1 vit pas hapjes se tenderit ne Piken Doganore dhe qe nuk është sqarim i vlefshëm pasi qe sipas nenit 72.3 thuhet:

72.3. Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Pra, OE i rekomanduar i ka vulos me dt. 14.05.2020 qe është afro 1 vit pas hapjes se tenderit, pasi qe tenderi është hap me dt. 17.09.2019 qe bie ndesh me nenin 72.3 te LPP-se.

Pra, edhe ne këtë pike OE "ALFA I" Lipjan ka dështuar sepse ka sjellë një DUD qe ndryshon nga DUD-i i bashkangjitur ne dosje.

Përgjigje në pretendimin nr. 2

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim konstaton se OE "Alfa I" ka dorëzuar DUD-i me nr. IE 0017986 i datës 14.05.2020 (fotokopje identike me origjinalin me nr. IE 0017986 i datës 02.10.2011 e cila është marre nga Zyra Doganore e Hanit të Elezit Republika e Kosovës me datën 14.05.2020) dhe e cila i është dorëzuar Panelit Shqyrtues me datën 14.05.2020 dhe i cili me vendimin 261/20 te datës 12.06.2020 kërkon nga AK-ja që të kërkohe informata shtese nga Operatori ekonomik konform nenit 59 dhe 72 te LPP-se , Komisioni vlerësues i tenderëve i caktuar nga Zyra e prokurimit me datën 30.07.2020 ka dale ne teren për te vizituar Kompaninë "Ekskavatori" në Ferizaj, me te cilën Operatori ekonomik "ALFA I" ka marrëveshje , për te identifikuar makinën-spërkatëse me emulsion si dhe ka pranuar Dudin Doganor për këtë pajisje. Komision vlerësues i tenderëve konstaton se OE "ALFA I" i plotëson te gjitha kushtet dhe kriteret e kërkuara me Njoftimin për Kontrate dhe Dosjen e tenderit .

Eksperti shqyrtues pas analizimit te këtij dokumentacioni konstaton se dokumentacioni i dorëzuar për spërkatësen me Emulsion (DUD-i me nr. IE 0017986 i datës 14.05.2020 (fotokopje identike me origjinalin e cila është marre nga Zyra Doganore e Hanit te Elezit Republika e Kosovës me datën 14.05.2020)) i plotëson kriteret e përcaktuara me Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për kontrate respektivisht te pikës III. 2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT. PAJISJET DHE MEKANIZIMI I OBLIGUESHËM dhe AFATI PËR KRYERJEN E PUNIMEVE si dhe është ne pajtim me nenin 39. Sqarimi i Tenderëve , respektivisht me paragrafin 39.3 Megjithatë, lejohet qe një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, te cilat mungojnë ne aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, ne mënyre objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës se publikimit te Njoftimit për kontrate. Andaj dokumenti i dorëzuar prezanton prova te mjaftueshme qe ne mënyrë te arsyeshme pasqyron gjendjen

ekzistuese para datës se publikimit të Njoftimit për kontratë.

Duke u bazuar në këto fakte ekspertit shqyrtues konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues është i pa bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues :

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertit shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, të anulohet B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES dhe rekomandon që lënda të kthehet në **RI-VLERËSIM**.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 28.09.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 28.09.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Kemi pranuar ekspertizën dhe nuk pajtohemi me të njëjtën për arsye të vijim:

Eksperti konstaton se rasti lidhur me spërkatësen e emulsionit ka qenë rast i gjykuar sipas Njoftimit të OSHP-se dhe pranohet si pretendim pjesërisht i bazuar i parashtruesit të ankesës, duke mos u bazuar në faktin se dëshmia nga Dogana është paraqitur në OSHP dhe Vendimi i këtij Organi ka rekomanduar që të kërkohej sqarime lidhur me këtë. I sqarojmë ekspertit se AK-ja e ka pranuar atë dëshmi si valide, pasi që ka qenë e vërtetuar nga Organi Kompetent-Dogana e Kosovës. Pra rasti i gjykuar nuk është ndryshuar nga AK-ja por këtë e ka diktuar rekomandimi nga Vendimi i OSHP-se. Po ashtu edhe eliminimi i tenderit të parashtruesit të ankesës është bërë në bazë të rekomandimit të OSHP-se dhe bazuar në këtë do të duhet të rekomandohej të vërtetohet propozimi ynë për dhënie të kontratës e jo rivlerësimi i aktivitetit.

Operatori Ekonomik, me datë: 29.09.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se **pajtohet pjesërisht (nuk pajtohet)** me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Pajtohem pjesërisht për raportin që lënda të kthehet në rivlerësim, por:

1. Nuk pajtohemi në piken e DUD-it doganor, që ekspertit nuk e ka shqyrtuar pasi që DUD-i është me datë 14.05.2020..Që i bie 8 muaj nga data e hapjes së tenderit dhe bie ndesh me nenin 72.3 të LPP.

Neni 72.3 i LPP-së

Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

2. Edhe eksperti edhe AK ne ekspertizën nr 33/20 janë pajtuar për çmime jo normalisht te ulëta, Kurse tani si kane përmendur fare Ku dihet se OE i rekomanduar është i papërgjegjshëm sipas nenit 61 te LPP.

3. Nuk e ka shqyrtuar rastin e teknikut te ndërtimtarisë qe nuk ka kontrate fare dhe nuk e përmbush kriterin e AK qe OE i rekomanduar nuk e plotëson kriterin e kërkuar te FDT sipas nenit 69 te LPP.

Kërkoj nga paneli qe ti analizoj pretendimet tona te pashqyrtuara nga eksperti.

Organi shqyrtues i Prokurimit ka kërkuar nga eksperti shqyrtues si me poshtë:

From: OSHP <oshp@rks-gov.net>

Sent: 05/Oct/20 14:29

To: dautretkoceri@gmail.com

Cc: Blerim Dina <Blerim.Dina@rks-gov.net>; Ardian Behra <Ardian.Behra@rks-gov.net>

Subject: 647/20 kerkese per sqarim nga eksperti

I nderuar;

lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Implementimi i planit të mobilitetit-rekonstruim i rrugës Muharrem Fejza" me nr. të prok: 616-19-6284-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "KK-Prishtinë" (KK.P),

A e keni shqyrtuar pretendimin e OE ankues per rastin e teknikut te ndërtimtarisë, ku ankuesi pretendon se ky teknik nuk ka kontrate fare dhe nuk e përmbush kriterin e AK .

A ka kerkuar AK sqarime per piken e cekur me larte nga OE I rekomanuar per kontrate dhe a ploteson kete kerkese ky OE.

Me respekt per ju.

Organi Shqyrtues i Prokurimit

Tel: 038/212-309

Prishtinë, 10 000

Rr. "MIGJENI" Ish Ndertesa e Bankes së Lublanës, Kati i V-të

e-mail: oshp@rks-gov.net

website: oshp.rks-gov.net

Eksperti shqyrtues profesional i prokurimit pergjigjet si me poshtë:

From: Daut Retkoceri <dautretkoceri@gmail.com>

Sent: 06/Oct/20 10:00

To: OSHP <oshp@rks-gov.net>; Blerim Dina <Blerim.Dina@rks-gov.net>; Ardian Behra <Ardian.Behra@rks-gov.net>;

Labeot Kabashi <Labeot.Kabashi@rks-gov.net>; Albulena.B.Gashi <albulena.b.gashi@rks-psh.org>

Subject: Plotësim i Raportit te Ekspertizës nr. 647/20

Te nderuar !

E gjeni te bashkangjitur kërkesën per sqarim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Implementimi i planit të mobilitetit-rekonstruim i rrugës Muharrem Fejza” me nr. të prok: 616-19-6284-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Prishtinë” (KK.P),

A e keni shqyrtuar pretendimin e OE ankues per rastin e teknikut te ndërtimtarisë, ku ankuesi pretendon se ky teknik nuk ka kontrate fare dhe nuk e përmbush kriterin e AK .

A ka kërkuar AK sqarime per piken e cekur me larte nga OE I rekomanduar per kontrate dhe a plotëson këtë kërkes ky OE.

Me respekt

Daut Retkoceri

Ekspert Shqyrtues

Të nderuar !

Pas kërkesës për sqarim nga PSH- OSHP-ja se “A e keni shqyrtuar pretendimin e OE ankues për rastin e teknikut të ndërtimtarisë, ku ankuesi pretendon se ky teknik nuk ka kontrate fare dhe nuk e përmbush kriterin e AK “ lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Implementimi i planit të mobilitetit- rekonstruim i rrugës Muharrem Fejza” me nr. të prok: 616-19-6284-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Prishtinë” (KK.P),

Ju njoftoj se nuk e kam shqyrtuar këtë pretendim andaj po e bashkangjes këtij Sqarimi:

PRETENDIMI NR.3

Lidhur me pretendimin e OE “Rahovica Commerce”s h.p.k. se sipas kërkesës në DT ka qenë të paraqiten dy teknik të ndërtimtarisë ndërsa OE“ALFA. I” i rekomanduar me kontratë ne ofertën e tij ka angazhuar personel profesional : z. Bekim Demaj me përgatitje shkollore - Shkollë të Mesme Teknike - Ndërtimtarie – profili arsimor – Murator (fasader) të shkallës së III-të të përgatitjes profesionale dhe z. Muhamet Demaj me përgatitje shkollore - Shkollë të Mesme Teknike - Ndërtimtarie – profili arsimor – Murator- Fasader të shkallës së III-të të përgatitjes profesionale,

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN NR.3

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim konstaton se OE “ALFA. I” në

dokumentacionin e dorëzuar me ofertë dhe kërkesave të kërkuar me FTD në dosjen e tenderit të kriteret e kërkuara pika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional , ku kërkohet që Operatori ekonomike duhet të angazhoj personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të më poshtme: - 2 Teknikë të Ndërtimtarisë me dy vite përvojë pune pas diplomimit. Andaj eksperti shqyrtues sqaron se kjo pikë e ankese është e qëndrueshme sepse OE “ALFA. I” në dokumentacionin e ofruar me ofertë për 2 Teknik të Ndërtimtarisë ka ofruar dokumentacionin të stafit me përgatitje shkollore - **“Shkollë të Mesme Teknike - Ndërtimtarie – profili arsimor – Murator- fasader të shkallës së III-të të përgatitjes profesionale”**, ndërsa përgatitja profesionale është kërkuar për këtë personel profesional **Shkolla e mesme teknike profili arsimor - Teknik i ndërtimtarisë të shkallës së IV-të të përgatitjes profesionale**. Andaj OE “ALFA. I” me ofertën e tij nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar pra nuk ka plotësuar kërkesat e kërkuara sipas FTD në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë siç është kërkuar pasi që ky kriter ka mundur që të ndikoj që shumë operator ekonomik të mos dorëzojnë ofertën e tyre sepse në stafin e tyre nuk kanë pasur me profil - **Teknik të Ndërtimtarisë** dhe nuk kanë menduar se me kuadër tjetër mundën me e plotësuar këtë kriter të kërkuar në pikën III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional me FTD në dosjen e tenderit.

Njeherit dhe për anëtarin e personelit të angazhuar si teknik i ndërtimtarisë z. Muhamet Demaj nuk ka ofruar kontratë të punës siç është kërkuar me Njoftimit për Kontratë dhe FTD në Dosjen e Tenderit

Duke u bazuar në këto fakte eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Me respekt !

Daut Retkoceri

Me poshtë i gjeni diplomat e përgatitjes profesionale për personelin profesional –Teknik Te ndërtimtarisë të ofruar nga OE” “ALFA. I” i cili nuk e plotëson kriteret e kërkuara në bazë të pikës III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional me FTD në dosjen e tenderit. Sepse ka ofruar me përgatitje profesionale me profil- Murator -Fasader


UNMIK

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERITËSE
Ministria e Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë

Nr. i shkollës sipas udhëzimit të
Ministrit të Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë

00080201
(numri)

Nr. i protokolli: 433/13

Mithat Frashëri në Tistog
(emri i shkollës)

DIPLOMË

PËR KRYERJEN E SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE

Muhamet Demaj
(emri dhe mbiemri)

i birt, e birt Khapërit lindur më 07.01.1985 në Tistog komuna Tistogut

krye shkollën e mesme Teknike-Mechimtare (tipi i shkollës) profili arsimor Muratori-fasader

të shkollës së Tistë (III^{te}) të përgatitjes profesionale me sukses të Shkëlqyeshëm (5)

Në Tistog
Më 06.06.2003



Drejtori
[Signature]

Formulari i këtij lloji të përdoret Ministria e Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë dhe vlen për vitin shkollor 2003/04.
Shën: SHËRPIJA BOTSUESE LIBRI SHKOLLOR - Prishtinë

Gjiri: 20 cent


UNMIK

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERITËSE
Ministria e Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë

Nr. i shkollës sipas udhëzimit të
Ministrit të Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë

00080201
(numri)

Nr. i protokolli: 427/13

Mithat Frashëri në Tistog
(emri i shkollës)

DIPLOMË

PËR KRYERJEN E SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE

Behar Demaj
(emri dhe mbiemri)

i birt, e birt Storshid lindur më 12.05.1985 në Tistog komuna Tistogut

krye shkollën e mesme Teknike-Mechimtare (tipi i shkollës) profili arsimor Muratori(fasader)

të shkollës së Tistë (III^{te}) të përgatitjes profesionale me sukses të Sh. mirë (4)

Në Tistog
Më 16.06.2003



Drejtori
[Signature]

Formulari i këtij lloji të përdoret Ministria e Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë dhe vlen për vitin shkollor 2003/04.
Shën: SHËRPIJA BOTSUESE LIBRI SHKOLLOR - Prishtinë

Gjiri: 20 cent

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 14.10.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit profesional deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Paneli shqyrtues sqaron se, duke analizuar pretendimet ankimore paneli ka hasur në një pretendim ankimor që nuk është analizuar fare nga ana e ekspertit shqyrtues andaj nga ky fakt ka kërkuar që te jepet konstatim edhe për këtë pikë.

Me datën 06.10.2020,eksperti shqyrtues ka analizuar pretendimin në fjalë dhe ka dhen konstatimin e tij se ky pretendimin është i qëndrueshme duke sqaruar në detaj pretendimin në fjalë.

Lidhur me pretendimin e OE "Rahovica Commerce" SH.P.K - Ferizaj, se OE i rekomanduar për kontrate ka çmime jo normalisht të ulëta sipas nenit 61 të LPP-së pasi që ka çmime tepër të ulëta të pozicioni MBISTRUKTURA në pozicionin 17 (Punimi i bitoagregatit 0 -22 mm, me trashësi $t=80.0$ mm i përzierje me përforcues asfalti me përbërje të fibrave të Aremidit dhe Polyolefineve) me çmime 6.20 €.

OE ka hyr me logjiken se nuk e bën fare përzierjen me përforcues të fibrave. Pasi që me çmimin ofertues edhe pa fibra është i lire e lere të beje përzierjen me fibra dhe te oferton me çmim 6.20 €/m2.

Paneli shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që janë pranuar në shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, Njoftimin nr. 33/20 të datës 12.02.2020 dhe Vendimin nr. 261/20 të datës 12.06.2020 të Panelit Shqyrtues konstaton se bazuar në rregulloren nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16, rastet e unifikuara par. 2) dhe 3), Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", sipas nenit 105.2.16 të LPP-së. Ky pretendim është shqyrtuar më parë me Njoftimin nr. 33/20 të datës 12.02.2020 ku paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës, raportin e ekspertit shqyrtues, parashtresës së AK –Komuna e Prishtinës se datës 04.02.2020 pas pranimi të raportit të ekspertit shqyrtues ku ka njoftuar OSHP-ne se PAJTOHET me mendimi e dhënë të ekspertit të OSHP-se të datës 03.02.2020 si

dhe parashtresës se OE "Rahovica Commerce" SH.P.K së datës 04.02.2020 pas pranimi të raportit të ekspertit shqyrtues ku ka njoftuar OSHP-në së PAJTOHET me mendimi e dhënë të ekspertit të OSHP-se të datës 03.02.2020.

Lidhur me pretendimin e OE "Rahovica Commerce" SH.P.K . – Lidhur me pajisjen "Spërkatëse për Bitumen dhe emulsion, po e sqarojmë me detajisht : Pra, lidhur me këtë pajisje dy here radhazi ka dështuar ta dëshmoj OE "ALFA I. Duke mos e argumentuar me sqarim (sipas nenit 59.2 dhe 72 te LPP-se) se e disponon këtë pajisje edhe OSHP dy here radhazi e ka dëshmuar se ky OE nuk e disponon këtë pajisje dhe automatikisht nuk e plotëson kriterin e FDT-se dhe NJK sipas nenit 59.4 te LPP-se, pasi qe nuk i plotëson te gjitha kriteret e kërkuara ne FDT dhe NJK.

Pretendimet tona qe i kemi paraqitur ne kërkesën për rishqyrtim i gjeni te bashkangjitur si me poshtë: DUD-i me nr. IE 0017986 i datës 14.05.2020 qe e dëshmon se OE e ka vulosur pas datës se hapjes se tenderit (17.09.2019), pra i bie afro 1 vit pas hapjes se tenderit ne Piken Doganore dhe qe nuk është sqarim i vlefshëm pasi qe sipas nenit 72.3 thuhet:

72.3. Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Pra, OE i rekomanduar i ka vulos me dt. 14.05.2020 qe është afro 1 vit pas hapjes se tenderit, pasi qe tenderi është hap me dt. 17.09.2019 qe bie ndesh me nenin 72.3 te LPP-se.

Pra, edhe ne këtë pike OE "ALFA I" Lipjan ka dështuar sepse ka sjellë një DUD qe ndryshon nga DUD-i i bashkangjitur ne dosje.

Paneli shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues konstaton se OE "Alfa I" ka dorëzuar DUD-i me nr. IE 0017986 i datës 14.05.2020 (fotokopje identike me origjinalin me nr. IE 0017986 i datës 02.10.2011 e cila është marre nga Zyra Doganore e Hanit të Elezit Republika e Kosovës me datën 14.05.2020) dhe e cila i është dorëzuar Panelit Shqyrtues me datën 14.05.2020 dhe i cili me vendimin 261/20 te datës 12.06.2020 kërkon nga AK-ja që të kërkohe informata shtese nga Operatori ekonomik konform nenit 59 dhe 72 te LPP-se , Komisioni vlerësues i tenderëve i caktuar nga Zyra e prokurimit me datën 30.07.2020 ka dale ne teren për te vizituar Kompaninë "Ekskavatori" në Ferizaj, me te cilën Operatori ekonomik "ALFA I" ka marrëveshje , për te identifikuar makinën-spërkatëse me emulsion si dhe ka pranuar Dudin Doganor për këtë pajisje. Komision vlerësues i tenderëve konstaton se OE "ALFA I" i plotëson te gjitha kushtet dhe kriteret e kërkuara me Njoftimin për Kontrate dhe Dosjen e tenderit .

Paneli shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues pas analizimit te këtij dokumentacioni konstaton se dokumentacioni i dorëzuar për spërkatësen me Emulsion (DUD-i me nr. IE 0017986 i datës 14.05.2020

(fotokopje identike me origjinalin e cila është marre nga Zyra Doganore e Hanit te Elezit Republika e Kosovës me datën 14.05.2020) i plotëson kriteret e përcaktuara me Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për kontrate respektivisht te pikës III. 2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT. PAJISJET DHE MEKANIZIMI I OBLIGUESHËM dhe AFATI PËR KRYERJEN E PUNIMEVE si dhe është ne pajtim me nenin 39. Sqarimi i Tenderëve , respektivisht me paragrafin 39.3 Megjithatë, lejohet qe një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, te cilat mungojnë ne aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, ne mënyre objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës se publikimit te Njoftimit për kontrate. Andaj dokumenti i dorëzuar prezanton prova te mjaftueshme qe ne mënyrë te arsyeshme pasqyron gjendjen ekzistuese para datës se publikimit te Njoftimit për kontrate.

Lidhur me pretendimin e OE "Rahovica Commerce"s h.p.k. se sipas kërkesës në DT ka qenë të paraqiten dy teknik të ndërtimtarisë ndërsa OE "ALFA. I" i rekomanduar me kontratë ne ofertën e tij ka angazhuar personel profesional : z. Bekim Demaj me përgatitje shkollore - Shkollë të Mesme Teknike - Ndërtimtarie – profili arsimor – Murator (fasader) të shkallës së III-të të përgatitjes profesionale dhe z. Muhamet Demaj me përgatitje shkollore - Shkollë të Mesme Teknike - Ndërtimtarie – profili arsimor – Murator- Fasader të shkallës së III-të të përgatitjes profesionale, **Paneli shqyrtues konform** Ekspertit shqyrtues konstaton se OE "ALFA. I" në dokumentacionin e dorëzuar me ofertë dhe kërkesave të kërkuar me FTD në dosjen e tenderit te kriteret e kërkuara pika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional , ku kërkohet që Operatori ekonomike duhet të angazhoj personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të më poshtme: - 2 Teknikë të Ndërtimtarisë me dy vite përvojë pune pas diplomimit. Andaj konstatojmë se kjo pikë e ankese është e qëndrueshme sepse OE "ALFA. I" në dokumentacioni e ofruar me ofertë për 2 Teknik të Ndërtimtarisë ka ofruar dokumentacionin të stafit me përgatitje shkollore - **"Shkollë të Mesme Teknike - Ndërtimtarie – profili arsimor – Murator- fasader të shkallës së III-të të përgatitjes profesionale"**, ndërsa përgatitja profesionale është kërkuar për këtë personel profesional **Shkolla e mesme teknike profili arsimor - Teknik i ndërtimtarisë të shkallës së IV-të të përgatitjes profesionale**. Andaj OE "ALFA. I" me ofertën e tij nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar pra nuk ka plotësuar kërkesat e kërkuara sipas FTD në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë siç është kërkuar pasi që ky kriter ka mundur që të ndikoj që shumë operator ekonomik të mos dorëzojnë ofertën e tyre sepse në stafin e tyre nuk kanë pasur me profil - **Teknik të Ndërtimtarisë** dhe nuk kanë menduar se me kuadër tjetër munden me e plotësuar këtë kriter të kërkuar ne piken III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional me FTD ne dosjen e tenderit. Njeherit dhe për anëtarin e personelit te angazhuar si teknik i ndërtimtarisë z.

Muhamet Demaj nuk ka ofruar kontratë të punës siç është kërkuar me Njoftimit për Kontratë dhe FTD në Dosjen e Tenderit, andaj duke u bazuar në këto fakte konstatojmë se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve për aktivitetin e prokurimit në fjalë nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së, dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët. Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Blerim Dina

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 /AK/ -"KK-Prishtinë" (KK.P),

1x1 / OE/ - "Rahovica Commerce" SH.P.K – Ferizaj,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.